



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 923 / Prot.  
4

Tiranë më 23.7.2019

VENDIM

Nr. 20, datë 23.7.2019

PËR KONTROLLUESIN "ZENITH TRAVEL SH.P.K"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Zenith Travel sh.p.k",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.185, datë 12.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 17.06.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Zenith Travel sh.p.k", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Zenith Travel sh.p.k", konstaton se:

1. Kontrolluesi, nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush Kontrolluesi, përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar: "...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39,

pika 1, gërma "d", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Kontrolluesi, nuk ka hartuar një rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre. Për këtë arsye duhet të hartohet një rregullore e detajuar e cila të jetë e zbatueshme në praktikë dhe të reflektojë edhe masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3. Kontrolluesi nuk ka vendosur Politikën e Privatësisë me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë portalin [www.zenithtravel.al](http://www.zenithtravel.al). Informacioni i publikuar në "Politikën e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

4. Kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV) dhe njofton klientët dhe punonjësit në lidhje me praninë e sistemit CCTV me tabela informuese, megjithatë këto tabela nuk janë sipas standardit të Udhëzimit nr.3/2010, "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" të Komisionerit.

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

5. Kontrolluesi, ka të parashikuar në Kontratën individuale të punës, në nenin 12 të saj, ruajtjen e konfidencialitetit. Gjithashtu, në nenin 9 të Kontratës, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e punëmarrësit, gjendet e parashikuar se: "Punëmarrësi

*duhet të ruajë sekret çdo informacion mbi të cilat ai vihet në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij në bazë të kësaj kontrate”.*

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 17.06.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit parashtrroi këto pretendime në procesverbal: *“Për tre ditë do të merren masa për plotësimin e konstatimeve të procesverbalit. Gjithashtu janë marra masa për vendosjen e tabelave informuese për sistemin e kamerave, sipas standardit të Komisionerit”.*

Kontrolluesi, më datë 19.06.2019 ka dërguar në rrugë elektronike, në cilësinë e provës materiale kopje të plotësuar të Formularin të *“Njoftimit”* si dhe rregullore specifike *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.*

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Zenith Travel sh.p.k”* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 02.07.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancë dëgjimore dhe është shprehur se para ushtrimit të hetimit administrativ nuk ishte në dijeni të detyrimeve ligjore dhe ka reaguar menjëherë për përmbushjen e tyre.

Në shkresat e dërguara nga ana e Kontrolluesit, ku dokumentohet rikuperimi i shkeljeve administrative, konstatohet se Formulari i Njoftimit ka nevojë të përditësohet në rubrikat *“Kategoritë e subjekteve të të dhënave”, “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen” dhe “Qëllimi i përpunimit”.* Gjithashtu, rregullorja e dërguar ishte sipas modelit standard të faqes së Komisionerit dhe nuk ishte përshtatur në përputhje me aktivitetin e ushtruar nga ana e Kontrolluesit.

Kontrolluesi *“Zenith Travel sh.p.k”*, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. Gjithashtu, kontrolluesi e ushtron veprimtarinë e tij që nga viti 2011, sikurse vërtetohet në QKB nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, kohë e mjaftueshme për t’u vënë në dijeni për detyrimet ligjore dhe për t’i zbatuar ato. Ndërkohë, në zbatim të Udhëzimit nr.47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, Kontrolluesi *“Zenith Travel sh.p.k”* konsiderohet subjekt përpunues i madh pasi përpunon një sasi të madhe të të dhënave personale të klientëve dhe punëmarrësve.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si dhe ka përmbushur detyrimet për kërkesat ligjore, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

## PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Zenith Travel sh.p.k", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve, përsa i përket plotësimit të Formularit të "Njoftimit", detyrim që buron nga neni 21, i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Zenith Travel sh.p.k", me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
3. Kontrolluesi "Zenith Travel sh.p.k", të realizojë përshtatjen e rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në përputhje me aktivitetin e ushtruar, si dhe të përditësojë formularin e "Njoftimit" përsa i përket rubrikave "Kategoritë e subjekteve të të dhënave", "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen" dhe "Qëllimi i përpunimit", brenda një periudhe prej 30 ditësh. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
5. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 23.7.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

